



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS V...

Numri i lëndës: 2024:208833

Datë: 14.08.2024

Numri i dokumentit: 06051739

P.nr.199/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit V.H nga Vushtrria, për shkak të veprave penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 KPRK-së si dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1260/24 e datës 06.08.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 12.08.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla, i dëmtuari R.Sh, i pandehuri V.H dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.L.H., më datë 12.08.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: V.H nga i ati Sh..., e ëma M..., e gjinisë S..., me date te lindjes... komuna e Vushtrrisë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon në ndërtim në kompaninë ... Group, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I. SEPSE: Më datë 23.07.2024, rreth orës 21:50, në V..., në rrugën “Xh.I”, afër lokalit “F...”, i pandehuri me dashje dhe fjalë serioze e kanos personin tjetër dhe atë të dëmtuarin R.Sh në atë mënyrë që, derisa i dëmtuari kishte qenë duke e drejtuar veturën e tij në rrugën e lartcekur, papritmas i pandehuri i ishte afruar tek xhami i veturës së shoferit dhe e kishte kanosur me fjalët “kujt ja nguc ti gruan” e ndërkohë e nxjerr një armë nga brezi dhe ia drejton atij duke i thënë “a e din që ti qes trutë në tokë” me çka tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe ankthit,

- Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 184 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së

II. SEPSE: Deri me datë 23.07.2024, rreth orës 21:50, në Vushtrri i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, Ligji nr.05/L-022, mban në posedim armën e tipit Zoraki 9mm, P.A.K, me karikator të zbrastë, me numër serik A3ZYR16YS01-2304768, armë e cila është sekuestruar nga policia e Kosovës,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 184 par.4 lidhur me par.1 dhe 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurin V.H:

Për pikën I të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) vite.

Për pikën II të dispozitivit i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej një mijë e dyqind (1200) euro, e që i njëjti do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak dhe atë nga data 23.07.2024 e gjerë me datë 12.08.2024 i'u është llogaritur gjatë përcaktimit të dënimit.

URDHËROHET- Konfiskimi i përhershëm i pistoletës të tipit Zoraki 9 mm, P.A.K, me karikator të zbrastë, me numër serik A3ZYR16YS01-2304768.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1260/24 e datës 06.08.2024, kundër të pandehurit V.H nga komuna e Vushtrrise, për shkak të veprave penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 KPRK-së si dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 12.08.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që: I pandehuri V.H ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtion gjykatës që në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në gjendjen faktike dhe provat materiale si në aktakuzë, gjykatës i propozon që me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, kërkim faljen e tij, premtimin e tij se nuk do te përsëris më vepra penale, si dhe faktin se i njëjti nuk ka të kaluar kriminale respektivisht është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin ndërsa si dhe rrethanat rënduese gjykata të vlerësoj nëse ekzistojnë kushtet e absorbimit të dashjes direkt ne kryerjen e veprës penale sipas pikës I të dispozitivit. Sa i përket propozimit të pikës III të aktakuzën për vazhdimin e masën se arrestit shtëpiak, duke pasur parasysh se i njëjti u deklarua fajtor për të dy pikat e dispozitivit, prokuroria në rastin konkret nuk konsideron se ekzistojnë kushtet që të njëjtit të i vazhdohet kjo masë, por që meqenëse rasti tashmë është ne procedurë gjyqësore i lejmë gjykatës ne vlerësim që te vlerësoj nëse ekzistojnë kushtet që kjo mase te vazhdohet respektivisht nëse ka rrezik të përsëritjes se veprës penale.

I dëmtuari R.Sh lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe me deklaratën e prokurores se shtetit, i njëjti njëherit nuk kërkon kompensimin e dëmit material dhe jo material lidhur me këtë çështje penale.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim av. L.H. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë, duke pasur parasysh që të mirët si rrethanë lehtësuese kërkim faljen që i mbrojturi i'a bëri sot ne seance gjyqësore të dëmtuarit, premtimin se nuk do të përsëris veprën, i njëjti më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, te ketë parasysh edhe zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit respektivisht të shqiptoj një dënim të kushtëzuar që ndikon në përmirësimin dhe risocializimin e të pandehurit.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin R.A, i datës 24.07.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin F.Sh, i datës 24.07.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin R.Sh.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprat penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 KPRK-së si dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 184 par.4 të KPRK-së është përcaktuar se “*Kushdo që kryen veprë penale nga ky nen ndaj viktimës së ndjeshme ose me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose ndonjë sendi tjetër me të cilin mund të shkaktohet lëndimi trupor ose dëmtimi i rëndë për shëndetin, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.*”, ndërsa në par.1 të nenit 184 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Kanosja e kryen “*Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*” Ndërsa në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*”

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 KPRK-së si dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale dhe se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të

pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak dhe atë nga data 23.07.2024 e gjerë me datë 12.08.2024 i'u është llogaritur gjatë përcaktimit të dënimit, ashtu siç përcaktohet në neni 79 par 1 të KPRK-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, konfiskimi, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 të KPPK-së, pasi që i dëmtuari kanë hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Urdhërin për konfiskimin e armës gjykata e ka marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.199/2024, datë 15.08.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.